

u bafkuan  
08.09.2016  
[Signature]

Tiranë, më 08/09/2016

**Objekti:** Shtesë në Kallzimin Penal të datës 01.09.2016, mbi "Grupin e Strukturuar Kriminal të Partisë Socialiste në Bashkinë Dibër, të angazhuar në kryerjen e veprave penale të blerjes së votës dhe kanosjes së votuesve".

**Drejtuar:** PROKURORISË PËR KRIME TË RËNDA, TIRANË

*I nderuar z. Prokuror,*

Në vijim të Kallzimit Penal të datës 01.09.2016, dhe shtesës së dërguar më datë 02.09.2016, jemi të detyruar të përcjellim edhe këto informacione shtesë, me qëllim hetimin e plotë, të gjithëanshëm dhe të shpejtë nga ana e organit të Prokurorisë. Sipas burimit të të dhënave të disponuar nga ana jonë, si dhe të përcjell në Kallzimin e datës 01.09.2016, rezulton edhe informacioni shtesë sa më poshtë:

Pjesë e Grupit të Strukturuar Kriminal, në cilësinë e organizatorit, sipas të dhanave rezulton të jetë edhe shtetasi Damian Gjikhuri, me detyrë Ministër i Energjetikës, i cili në një takim të zhvilluar në qytetin e Peshkopisë, ku merrnin pjesë disa nga anëtarët e shtabit elektoral të Partisë Socialiste, midis tyre edhe kandidati Muharrem Rama dhe shtetasi Ymer Lala, është shprehur se: "*Kemi porosi nga Shefi<sup>1</sup>, që zgjedhjet duhen marrë me cdo cmim. Dhe vota nuk ka cmim. Këto nuk janë zgjedhje lokale, por janë test për zgjedhjet e ardhshme dhe duhen marrë me patjetër. Për lek mos u kurseni fare*". Pikërisht në këtë takim është udhëzuar edhe mbi skemën e shpërndarjes së parave, ku sic ju kemi bërë me dije edhe më parë shtetasit e përmendur në kallëzim, bëjnë shpërndarjen e fondeve financiare që përdoren për blerje votash pranë secilit prej Administratorëve të Njësive Vendore, dhe këta të fundit marrin kontakt me secilin prej Kryepleqëve të zonave përkatës, të cilët më tej kontaktojnë zgjedhësit dhe bëjnë shpërndarjen e parave, në këmbim të votave për kandidatin e ASHE z. Muharrem Rama.

Veprimtaria kriminale e ministrit Damian Gjikhuri, ka vazhduar edhe në publik, ku duke shfrytëzuar funksionin e tij publik, në një takim në njësinë e Kastriotit, më datë 23 Gusht 2016, ka kërcënuar qytetarët e Bashkisë Dibër, për mungesë mbështetje me financime nga Qeveria,

<sup>1</sup> "Shefi" nënkupton sipas të gjitha rrethanave Kryeministrin Edi Rama

në rast të fitores së kandidatit të Partisë Demokratike. Konkretisht, në këtë takim, ai është shprehur se: *“Populli i Dibrës nuk ka arsye të bëjë eksperiment të gabuar dhe të mos votojë kandidatin e qeverisë. Dibra është një krahinë me probleme dhe ka nevojë për investime. Si do bëhet e mundur kjo? Me një kandidat që e mbështet qeveria, që e ka mbështetjen pas.”*

Nga ana tjetër, dëshirojmë t’ju bëjmë me dije se për motive politike dhe për shkak të mosmbështetjes së kandidatit të ASHE z. Muharrem Rama, kanë filluar largimet nga puna të zyrtarëve publik. Konkretisht, duke marrë paraprakisht lejen e qytetarëve të prekur nga veprimtaria kriminale e këtij grupi të strukturuar, ju informojmë se punonjësi i gjendjes civile të Lurës z. Faik Hoti, dhe punonjësi i gjendjes civile të Kastriotit z. Bashkim Dida, janë shkarkuar nga detyra, pa asnjë shkak të ligjshëm, për motive të qarta politike dhe si pasojë e aplikimit të skemës kërcënuese të njoftuar më parë nga ana jonë.


Ne vlerësojmë të nevojshëm përcjelljen e këtij informacioni shtesë, bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, me qëllim mundësimin e një hetimit të shpejtë dhe efikas nga ana e organit të prokurorisë. Shprehim besimin tonë, se ndërhyrja e menjëhershme e organit të prokurorisë është domosdoshmëri për të mos lejuar deformimin, me metoda kriminale, të rezultatit të zgjedhjeve në Bashkinë Dibër. Garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, jashtë cdo metode që synon deformimin kriminal të tyre, është shërbim ndaj demokracisë funksionale në Shqipëri, si dhe përgjigjia e duhur ligjore ndaj këtij grupi të strukturuar kriminal.

Në pritje të një reagimi të shpejtë dhe efikas nga ana Juaj,

Me respekt,

**KALLZUESI**

**EDI PALOKA**

  
\_\_\_\_\_  
(nënshkrim)